

LIGJI Nr. 06/L -036**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 04/L-219 PËR TË HUAJT****Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT Nr. 04/L-219 PËR TË HUAJT**Neni 1****Qëllimi**

1. Qëllimi i këtij ligji është ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr. 04/L-219 për të Huajt (Gazeta Zyrtare nr. 35, e datës 5 shtator 2013), në tekstin e mëtejme Ligji.

2. Ky ligj është në përputhje me:

2.1. Direktivën 2014/66/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta në suaza të transfereve brenda Korporatave;

2.2. Direktiva 2014/36/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetasve të vendeve të treta me qëllim të punësimit si punëtor sezonal;

2.3. Direktivën 2016/801 BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 maj 2016 mbi kushtet e hyrjes dhe qëndrimit të shtetaseve të vendeve të treta për qëllim hulumtimi, studimi, trajnimi, shërbimi vullnetar, skema të shkëmbimit të nxënësve, apo projekte arsimore si dhe au pairing;

2.4. Rregullore (BE) Nr. 610/2013 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 26 Qershor 2013 që ndryshon Rregulloren (KE) Nr. 562/2006 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit që nxjerr Kodin e Bashkësisë mbi rregullat e me të cilat rregullohet lëvizja e personave përtej kufijve (Kodi i Kufijve të Shengenit), Konventa mbi zbatimin e Marrëveshjes së Shengenit, Rregulloret e Këshillit (KE), Nr. 1683/95 dhe (KE) Nr. 539/2001 dhe Rregulloret (KE) Nr. 767/2008 dhe (KE) Nr. 810/2009 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit.

Neni 2

1. Neni 3, paragrafi 1, nënparagrafët 1.18, 1.19 dhe 1.25 të Ligjit bazik, riformulohen me tekstin si në vijim:

1.18. APRK - Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës;

1.19. Punëtor sezonal - i huaji që banon në shtetin e të cilit ai/ajo është shtetas ose në të cilin ai ose ajo ka një leje qëndrimi të përhershme jashtë Republikës së Kosovës dhe qëndron në mënyrë të ligjshme dhe të përkohshme në territorin e Republikës së

Kosovës, për të kryer një aktivitet që varet nga kalimi i sezonës, në bazë të një ose më shumë kontratave të punës me afat, të lidhura direkt në mes të huajit dhe punëdhënësit në Republikën e Kosovës;

1.25. Kthimi - Proces i kthimit mbrapa i një të huaji, qoftë në pajtim me një obligim vullnetar apo të detyrueshëm për t'u kthyer në vendin e origjinës, ose në vendin transit në pajtim me marrëveshjet ndërkombëtare ose vendit ku i huaji ka të drejtë të qëndrojë.

2. Neni 3, i Ligjit bazik, pas përkufizimit "sponsor" të nënparagrafit 1.29, shtohen edhe katër përkufizime të reja si në vijim:

1.30. I transferuar brenda korporatave – i huaji që në kohën e aplikimit për leje për qëndrim të përkohshëm, qëndron jashtë territorit të Republikës së Kosovës dhe është deleguar përkohësisht për qëllime profesionale ose trajnuese nga një ndërmarrje që gjendet jashtë territorit të Republikës së Kosovës dhe me të cilën i huaji është i lidhur me një kontratë pune para dhe gjatë transferimit në ndonjë subjekt që i takon ndërmarrjes apo të njëjtit grup të ndërmarrjeve, që gjendet në Republikën e Kosovës;

1.31. Menaxher - një person që ka pozitë të lartë, që kryesisht drejton menaxhimin e subjektit pritës, duke pasur mbikëqyrje apo udhëheqje parimisht nga bordi i drejtorëve apo nga aksionarët e biznesit ose ekuivalente, ajo pozitë përfshinë: drejtimin e subjektit pritës apo një departament ose nëndivizion të subjektit pritës, mbikëqyrë dhe kontrollon punën e punonjësve tjerë mbikëqyrës, punëtorëve profesional ose menaxhues, që ka autoritet për të rekomanduar punësimin, largim apo veprime tjera me personel;

1.32. Specialist - person që punon brenda grupit apo ndërmarrjes, i cili ka njohuri të specializuara thelbësore për fushat e aktiviteteve të subjektit pritës, për teknikat apo për menaxhim. Në vlerësimin e njohurisë së tillë, nuk do të merren parasysh vetëm njohuritë specifike për subjektin pritës, por gjithashtu nëse personi ka nivel të lartë të kualifikimit, përfshirë përvojën adekuate profesionale, duke iu referuar llojit të punës apo aktiviteteve që kërkojnë njohuri specifike teknike, duke përfshirë anëtarësimin e mundshëm të një profesioni të akredituar;

1.33. Praktikant - personi me diplomë universitare ose është duke ndjekur studimet që është transferuar në një subjekt pritës për zhvillim të karrierës apo për t'u trajnuar në teknikat apo metodat e biznesit, dhe paguhet gjatë kohës së transferimit.

Neni 3

Neni 28, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, i Ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

1.4. Ka qëndruar nëntëdhjetë (90) ditë gjatë periudhës kohore prej njëqind e tetëdhjetë (180) ditë në Republikën e Kosovës.

Neni 4

Neni 31, paragrafi 1 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Të huajit mund t'i lejohet të hyjë në Republikën e Kosovës për qëndrimet që nuk i kalojnë nëntëdhjetë (90) ditë brenda periudhës njëqind e tetëdhjetë (180) ditëve dhe nëse ai ose ajo plotëson kushtet si në vijim:

Neni 5

Neni 33, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4, i Ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

1.4. Ka konsumuar afatin prej nëntëdhjetë (90) ditëve të qëndrimit brenda njëqind e tetëdhjetë (180) ditëve.

Neni 6

Neni 38, i Ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Qëndrimi afatshkurtër nënkupton qëndrimin e një të huaji deri në nëntëdhjetë (90) ditë brenda periudhës kohore prej njëqind e tetëdhjetë (180) ditë pa vizë ose me vizë kur kjo kërkohet.

2. Qëndrimi afatshkurtër mund të jetë më i shkurt se nëntëdhjetë (90) ditë kur kjo përcaktohet me vizë. Periudha e qëndrimit llogaritet prej ditës së parë të hyrjes në Republikën e Kosovës.

3. I huaji i cili tashmë e ka shfrytëzuar afatin e qëndrimit prej nëntëdhjetë (90) ditë brenda periudhës kohore prej njëqind e tetëdhjetë (180) ditë, mund të hyjë prapë dhe të qëndrojë në Republikën e Kosovës pas kalimit të periudhës kohore prej njëqind e tetëdhjetë (180) ditëve nga dita e hyrjes së parë.

Neni 7

1. Neni 41, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

1.4. Arsye humanitare, duke përfshirë refugjatët, personat nën mbrojtje plotësuese, dhe personat me status të pa shtetësisë; viktimat e trafikimit me njerëz ose viktimave të kontrabandës me migrant dhe të huajt të cilët kanë shprehur vullnet të bashkëpunimit me autoritete kompetente.

2. Neni 41, paragrafi 4, i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

4. Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij Neni, të huajit mund t'i jepet qëndrimi i përkohshëm edhe për qëllime të tjera.

Neni 8

Neni 43, paragrafi 1, i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Kërkesën për lejeqëndrim të përkohshëm i huaji e parashtron personalisht, ndërsa për fëmijët, fëmijët të pashoqëruar apo personave të ndjeshëm, kërkesa parashtrohet nga prindërit, njëri prind me autorizim të prindit tjetër apo kujdestari ligjor.

Neni 9

Neni 45, paragrafi 1, i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Prindërit, njëri prind me autorizim të prindit tjetër apo kujdestari i fëmijës të lindur në Republikën e Kosovës është i obliguar të parashtrojë kërkesë për lejeqëndrim të përkohshëm për fëmijën, jo më vonë se nëntëdhjetë (90) ditë nga data e lindjes.

Neni 10

1. Neni 47, paragrafi 1, i Ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Kërkesa për vazhdimin e lejes së qëndrimit të përkohshëm duhet të paraqitet brenda tridhjetë (30) ditëve para skadimit të lejeqëndrimit të përkohshëm në DSHAM.

2. Neni 47, pas paragrafit 5, të Ligjit bazik, shtohen edhe dy paragrafe të reja me tekstin si në vijim:

6. Të huajt, të cilët aplikojnë për vazhdim të leje qëndrimit të përkohshëm dhe nuk e ndërrojnë qëllimin e aplikimit paraprak, parashtrojnë kërkesë për vazhdim të leje qëndrimit të përkohshëm në DSHAM dhe duhet t'i paraqesin dokumentet si në vijim:

6.1. Dokument të vlefshëm udhëtimi;

6.2. Dëshmi që posedon mjete të mjaftueshme për jetesë;

6.3. Sigurim shëndetësor;

6.4. Dëshmi që nuk është i dënuar nga gjykata.

7. I huaji nga paragrafi 6, i këtij neni, nuk mund ta vazhdojë leje qëndrimit të përkohshëm në qoftë se është i dënuar me aktgjykim të formës së prerë me dënim mbi një (1) vit burg.

Neni 11

1. Neni 48, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5, i Ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

1.5. Nuk ka ndalesë të hyrjes dhe qëndrimit në Republikën e Kosovës ose nuk përfaqëson rrezik për imigrim të paligjshëm ose qëndrimit të paligjshëm në Republikën e Kosovës.

2. Neni 48, pas paragrafit 1 shtohet një (1) nënparagraf i ri 1.7, me tekstin si në vijim:

1.7. I huaji, i përcaktuar sipas paragrafit 1.4 të nenit 7, të këtij Ligji, përjashtohet nga kushtet e parapara në nenin 48, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 të ligjit bazik.

Neni 12

1. Neni 49, pas nënparagrafit 1.4 të Ligjit bazik, shtohet një nënparagraf i ri 1.5, me tekstin si në vijim:

1.5. Të huajit, të cilit i është dhënë statusi i personit pa shtetësi.

2. Neni 49, paragrafi 2, i Ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

2. Pavarësisht nga paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 i këtij neni, anëtarit të ngushtë të familjes së të huajit i cili qëndron në Republikën e Kosovës në bazë të lejeqëndrimit të përkohshëm për punë të lëshuar për një (1) vit, mund t'i jepet lejeqëndrimi i përkohshëm me qëllim të ribashkimit familjar, vetëm nëse i huaji kërkon bashkim familjar në Republikën e Kosovës dhe nëse i ka të paktën dy (2) vjet të qëndrimit të përkohshëm. Ky përjashtim nuk vlen për të transferuarit brenda korporatave, familjarët e të cilëve kanë të drejtë aplikimi për leje qëndrimi të përkohshëm në të njëjtën kohë me sponsorin.

Neni 13

Neni 57, pas paragrafit 3 të Ligjit bazik shtohet paragrafi i ri me tekstin si në vijim:

4. Studenti i diplomuar në ndonjërin nga institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Kosovës, e që kërkon punësim, i vazhdohet kërkesa për lejeqëndrim edhe për nëntë (9) muaj. Kërkesa duhet të parashtrohet brenda tre (3) muajve nga dita e diplomimit të tij.

Neni 14

Neni 58, pas paragrafit 3, të ligjit bazik shtohet paragrafi i ri 4, me tekstin si në vijim:

4. Hulumtuesit shkencorë që kanë marrëveshje me ndonjërin nga institucionet e licencuara në Republikën e Kosovës, i vazhdohet kërkesa për lejeqëndrim të përkohshëm edhe për nëntë (9) muaj. Kërkesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve para skadimit të lejeqëndrimit të tij.

Neni 15

Neni 59, Paragrafi 2, i Ligjit bazik, fshihet.

Neni 16

Neni 66, i Ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

Neni 66

Refuzimi dhe revokimi i leje qëndrimit të përkohshëm

1. Kërkesa për lejeqëndrim të përkohshëm ose vazhdimin e lejeqëndrimit të përkohshëm refuzohet kur:

1.1. Kushtet për dhënien ose vazhdimin e lejeqëndrimit të përkohshëm nuk janë plotësuar;

1.2. Nëse dokumentet e paraqitura janë siguruar me mashtrim, ose të falsifikuara ose janë ndërruar.

2. Lejeqëndrimi i përkohshëm i revokohet të huajt nëse:

2.1. Pushojnë kushtet për dhënien e qëndrimit të përkohshëm sipas nenit 48 të ligjit bazik;

2.2. Qëndron jashtë territorit të Republikës së Kosovës për më shumë se tridhjetë (30) ditë pandërprerë pa ndonjë arsye;

2.3. Nëse qëndrimi i tij në Republikën e Kosovës është në kundërshtim me qëllimin e qëndrimit të përkohshëm;

2.4. Nëse dokumentet e paraqitura nga i huaji janë siguruar me mashtrim, ose janë falsifikuar, ose janë ndërruar.

3. Vendimi sipas paragrafit 2, nënparagrafi 2.2 dhe 2.3 të këtij neni, mund të merret pa një dëgjim paraprak të të huajt, përderisa paraprakisht ai ka qenë i njoftuar se ndaj tij është duke u zhvilluar procedura për revokimin e qëndrimit të përkohshëm.

4. Kundër vendimit sipas paragrafëve 1 dhe 2 të këtij neni, mund të parashtrohet ankesë në Komisionin e Ankesave.

5. Përjashtimisht nga paragrafi 2, nënparagrafi 2.2, të këtij neni, i huaji i cili qëndron jashtë Republikës së Kosovës nëntëdhjetë (90) ditë për shkaqe të arsyeshme, qëndrimi i përkohshëm nuk do t'i revokohet vetëm nëse e njofton DSHAM-në ose Policinë Kufitare për arsyet e qëndrimit të tij jashtë vendit, jo më vonë se dhjetë (10) ditë nga data e kthimit në Republikën e Kosovës. DSHAM nxjerr vendim duke marrë parasysh informacionin e dhënë nga i huaji.

Neni 17

Pas nenit 66, të Ligjit bazik, shtohet neni 66 A, me tekstin si në vijim:

Neni 66 A **Personat e padëshiruar**

1. Ministri i Punëve të Brendshme, për interesa të rëndësishme të shtetit, të rendit kushtetues dhe atij juridik, të sigurisë shtetërore e të rendit publik, me vendim të argumentuar shpall person të padëshiruar një të huaj nëse:

1.1. vepron ose propagandon kundër sovranitetit të Republikës së Kosovës, sigurisë shtetërore, rendit kushtetues dhe rendit e sigurisë publike;

1.2. është anëtar i organizatave terroriste, ose përkrah e kryen veprime kundër

shtetit ligjor;

1.3. përbën kërcënim për vendin, ose cenon marrëdhëniet e Republikës së Kosovës me shtete të tjera;

1.4. ekzistojnë dyshime se do të hyjë ose do të qëndrojë në territorin e Republikës së Kosovës, për të kryer një vepër penale apo veprime, që përbëjnë kërcënim për Republikën e Kosovës;

1.5. është i përfshirë në krimin e organizuar, në trafikimin e qenieve njerëzore, drogë, si dhe në çdo trafik tjetër të paligjshëm, sipas të dhënave të marra nga institucionet përgjegjëse të sigurisë kombëtare.

2. I huaji shpallet “person i padëshiruar” për një periudhë jo më pak se pesë (5) vjet nga data e shpalljes dhe i refuzohet hyrja ose qëndrimi në Republikën e Kosovës gjatë kësaj periudhe.

3. Ministri i Punëve të Brendshme, me kërkesën e të huajit, mund të rishikojë kërkesën për hyrje, vizë ose lejeqëndrim, në rast se i huaji i moshës madhore ka kryer njërin nga aktet e përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni në moshë të mitur.

4. Procedura e shpalljes së të huajit person i padëshiruar rregullohet me Udhëzim Administrativ, i cili nxjerrët nga Ministri i Punëve të Brendshme në bashkëpunim me Ministrin e Punëve të Jashtme.

Neni 18

1. Neni 67, paragrafit 1, i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

1. I huaji në Republikën e Kosovës mund të punojë në bazë të lejes së qëndrimit për punë, ose në bazë të lejes së punës afatshkurtër për të huajt, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, me marrëveshje ndërkombëtare të njohura nga Republika e Kosovës apo me Vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

2. Neni 67, paragrafi 3 nënparagrafi 3.2 dhe 3.3, i Ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

3.2. Me status të refugjatit, mbrojtje të përkohshme ose plotësuese dhe me status të personave pa shtetësi;

3.3. Me qëndrim të përkohshëm me qëllim të ribashkimit familjar me shtetas të Republikës së Kosovës, me të huaj me leje qëndrim të përhershëm, me të huaj me leje qëndrim të përkohshëm pas një (1) viti, me të huaj me status të refugjatit, si dhe të huaj të cilëve iu është aprovuar mbrojtja plotësuese ose mbrojtja e përkohshme dhe me një të huaj që është i transferuar brenda-korporatës, si dhe të huajve me lejeqëndrim të përkohshëm me arsye studimi.

Neni 19

Neni 71, nënparagrafi 1.4, i Ligjit bazik, fshihet në tërësi.

Neni 20

1. Neni 74, paragrafët 3 dhe 4, të Ligjit bazik, riformulohen me tekstin si në vijim:

3. Përjashtimisht nga paragrafi 2, i këtij neni, leje qëndrimi për punë, të huajit nga neni 70, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5, 1.6 dhe 1.13 të këtij ligji i lëshohet me afat të vlefshmërisë prej dy (2) vitesh, nëse nuk është kërkuar periudha më e shkurtër e lëshimit të leje qëndrimit për punë.

4. Shtetasi i huaj, të cilit i është lëshuar leje qëndrimi për punë për shkak të kryerjes së punëve sezonale, mund të qëndrojë në Republikën e Kosovës më së gjati gjashtë (6) muaj, në periudhën kohore prej dymbëdhjetë (12) muaj dhe patjetër duhet të qëndrojë jashtë Republikës së Kosovës më së paku gjashtë (6) muaj, para se t'i bëhet përsëri e mundur hyrja dhe qëndrimi me qëllim të punës.

2. Neni 74, pas paragrafit 5, të ligjit bazik, shtohet një paragraf i ri 6, me tekstin si në vijim:

6. Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, DSHAM merr vendim lidhur me kërkesën për leje qëndrim për punë edhe pa konfirmimin e APRK-së, përderisa nuk është nxjerr kuota vjetore e punësimit.

Neni 21

Neni 75, i Ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Të huajit mund t'i refuzohet lëshimi i leje qëndrimit për punë në ato raste kur:

1.1. punëdhënësi shkel dispozitat e punës dhe dispozitat e mbrojtjes në punë, sigurimit shëndetësor dhe pensional, shmangja nga tatimi ose në rastet kur i huaji ose punëdhënësi nuk kanë paguar një gjobë me para;

1.2. ndërmarrja e punëdhënësit është duke u mbyllur apo është mbyllur në bazë të legjislacionit përkatës në fuqi të falimentimit ose asnjë aktivitet ekonomik nuk është duke u zhvilluar;

1.3. shtetasi i huaj nuk ka respektuar detyrimet që rrjedhin nga një vendim paraprak për pranim si punëtor sezonal;

1.4. punëdhënësi ka qenë i sanksionuar në përputhje me ligjin në fuqi për punë të padeklaruar dhe/ose punësim të paligjshëm;

1.5. i huaji nuk i është përmbajtur obligimeve që kanë dalë nga vendimi i mëparshëm për punë;

1.6. ndërmarrja është themeluar për qëllim kryesor të lehtësimit të hyrjes së të huajve;

1.7. është arritur maksimumi i qëndrimit i përcaktuar në nenin 74, paragrafi 4 të ligjit bazik.

2. Një i huaj është punëtor sezonal nëse ka qëndruar në Republikën e Kosovës për gjashtë (6) muaj në një periudhë kohore prej dymbëdhjetë (12) muajsh.

Neni 22

1. Titulli i nenit 76, i Ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

“Leje pune afatshkurtër për të huaj”.

2. Neni 76, paragrafi 1, i Ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Në bazë të lejes së punës afatshkurtër deri në nëntëdhjetë (90) dite brenda çdo periudhe prej njëqindetëdhjetë (180) ditëve brenda një (1) viti, mund të punojnë të huajt si vijon.

3. Neni 76, i ligjit bazik, pas nënparagrafit 1.17, shtohet tre nënparagrafë të rinjë 1.18, 1.19, 1.20, me tekstin si në vijim:

1.18. Mjekë ose specialistë të fushave të ndryshme mjekësore;

1.19. Arsimitarët dhe ligjëruesit e institucioneve të jashtme kulturore, arsimore dhe shkencore angazhimi i të cilëve është jo më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë brenda çdo periudhe prej njëqindetëdhjetë (180) ditësh brenda një (1) viti të pajisen me leje të punës afatshkurtër për të huaj;

1.20. Anëtarët e bordeve dhe drejtorët ekzekutiv të përfaqësive të huaja, të cilët angazhimi i tyre nuk është më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë brenda çdo periudhe prej njëqindetëdhjetë (180) ditësh brenda një (1) viti të pajisen me leje të punës afatshkurta për të huaj.

4. Neni 76, i ligjit bazik, pas nënparagrafit 3.4, shtohet një nënparagraf i ri me tekstin si në vijim:

3.5. Punëtorët sezonal, angazhimi i të cilëve është jo më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë brenda çdo periudhe prej njëqindetëdhjetë (180) ditësh brenda një (1) viti, të cilët janë të pakualifikuar nuk mund të pajisen me leje të punës afatshkurtër për të huaj.

5. Në tërë tekstin e ligjit bazik, termi “vërtetim për lajmërimin e punës”, të zëvendësohet me termin “leje pune afatshkurtër për të huaj”.

Neni 23

Neni 78, pas paragrafit 2, të ligjit bazik, shtohet një paragraf i ri 3 me tekstin si në vijim:

3. Kohëzgjatja maksimale e një transferimi brenda korporatës do të jetë tre (3) vjet për menaxherë dhe specialistë dhe një (1) vit për praktikantë.

Neni 24

1. Neni 81, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, i Ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

1.4. I huaji punon për punëdhënësin por nuk i është lëshuar lejqëndrimi për punë ose punëdhënësi ka qenë i sanksionuar në përputhje me ligjin në fuqi për punë të padeklaruar dhe/ose punësim të paligjshëm.

2. Neni 81, paragrafi 1, të Ligjit bazik, pas nënparagrafit 1.11, shtohen edhe dy nënparagrafë 1.12 dhe 1.13, me tekstin si në vijim:

1.12. Subjekti pritës është themeluar për qëllim kryesor të lehtësimit të hyrjes së të huajve, i cili nuk ushtron ndonjë aktivitet tjetër;

1.13. Ndërmarrja e punëdhënësit është duke u mbyllur apo është mbyllur në bazë të ligjeve në fuqi të falimentimit ose asnjë aktivitet ekonomik nuk është duke u zhvilluar.

Neni 25

1. Neni 83, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, i Ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

1.1. Kushtet e punësimit, duke përfshirë moshën minimale për punë, dhe kushtet e punës duke përfshirë pagën dhe largimin nga puna, orarin e punës, pushimi dhe festat, si dhe sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës.

2. Neni 83, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, i Ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

1.2. Të drejtën në grevë dhe në ndërmarrjen e veprime industriale, në përputhje me legjislacionin e aplikueshëm në Kosovë, dhe lirinë e asociimit, bashkimit dhe anëtarësimit në një organizatë që përfaqëson punëtorët ose çdo organizatë, anëtarët e të cilëve janë të angazhuar në një profesion të veçantë, përfshirë të drejtat dhe përfitimet e dhëna nga organizata të tilla, përfshirë të drejtën për të negociuar dhe lidhur marrëveshje kolektive, pa cenuar legjislacionin e Republikës së Kosovës që ka të bëjnë me politikën publike dhe sigurinë publike.

3. Neni 83, pas nën-paragrafit 1.6, të Ligjit bazik shtohen dy nënparagrafë 1.7 dhe 1.8, me tekstin si në vijim:

1.7. Pagesat e mbetura të bëhen nga ana e punëdhënësit, në lidhje me çdo pagesë të pashlyer ndaj shtetasit të huaj;

1.8. Përfitimet tatimore, për aq sa punëtori sezonal konsiderohet të jetë rezident për qëllime tatimore në Republikën e Kosovës.

Neni 26

Pas nenit 83, të Ligjit bazik, shtohet neni 83/A, me tekstin si në vijim:

Neni 83/A

Zyrtarët e institucionit kompetent kanë të drejtë të kryejnë intervista me të huajin dhe me ftuesin e tij/saj që të kërkojnë shpjegime dhe dokumente shtesë, që arsyetojnë hyrjen dhe qëllimin e vizitës dhe vërtetësinë e informatave të ofruara nga i huaji, si dhe të verifikojnë informatat e ofruara nga i huaji dhe ftuesi i tij/saj që të marrin vendim për lëshimin ose vazhdimin e vizës, lejes së qëndrimit, lejes së punës ose autorizimin për nevoja të punës.

Neni 27

Neni 84, paragrafi 1 i Ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Leje qëndrimi i përhershëm mund ti jepet të huajit i cili në kohën e parashtrimit të kërkesës posedon leje qëndrim të përkohshëm pandërprerë prej pesë (5) vjetëve në Republikën e Kosovës, përveç rasteve me martesë me shtetasin e Republikës së Kosovës apo me të huajin me qëndrim të përhershëm, nevojitet tri (3) vite qëndrim të pandërprerë.

Neni 28

Neni 85, i Ligjit bazik, pas paragrafit 2 shtohet paragraf i ri 3 me tekstin si në vijim:

3. Përgjashtimisht nga paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe 1.2, si dhe paragrafit 2, të Ligjit bazik, personave me mbrojtje ndërkombëtare nëse procedura e vendimmarrjes zgjat më shumë se tetëmbëdhjetë (18) muaj, llogaritja e kohës bëhet nga data e kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare. Kurse, nëse procedura zgjat me pak se tetëmbëdhjetë (18) muaj, llogaritja e kohës bëhet sa gjysma e procedurës.

Neni 29

1. Neni 86, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 dhe 1.2, i Ligjit bazik riformulohet me tekstin si në vijim:

1.1. I huaji, i cili deri në ditën e parashtrimit të kërkesës ka së paku pesë (5) vjet me status të refugjatit dhe të mbrojtjes plotësuese sipas Ligjit për Azil;

1.2. Të huajit, të cilët kanë qëndruar në territorin e Republikës së Kosovës së paku pesë (5) vjet pa ndërprerë dhe të cilët konstatohet se kanë lidhje të ngushta ekonomike dhe familjare në Republikën e Kosovës. Qëndrimi i tyre vërtetohet me dokumente që dëshmojnë qëndrimin e tij të pandërprerë në territorin e Republikës së Kosovës.

2. Neni 86, pas paragrafit 1, shtohet paragrafi i ri 2, me tekstin si në vijim:

2. Procedura për dhënien e lejeqendrimit të përhershëm në rrethanat e jashtëzakonshme rregullohet me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri i Punëve të Brendshme.

Neni 30

Neni 89, pas nënparagrafit 3.3 i ligjit bazik, i shtohet një nënparagraf i ri 3.4, me tekstin si në vijim:

3.4. Të gjithë të huajt që e kanë gjuhë amtare njërën nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.

Neni 31

1. Në tërë tekstin e ligjit bazik, termi “Urdhër”, zëvendësohet me termin “Vendim”.

2. Neni 94, paragrafi 1 i Ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Policia e Kosovës nxjerr vendim për largimin e të huajve që qëndrojnë në mënyrë të paligjshme në territorin e Republikës së Kosovës ose kur i huaji ka vuajtur një dënim të dhënë nga gjykatat kompetente për një vepër penale, për të cilën Kodi Penal i Republikës së Kosovës parashikon një dënim minimal një (1) vit me burgim.

3. Neni 94, i ligjit bazik, pas paragrafit 10, shtohen edhe tre paragrafë të ri 11, 12 dhe 13, me tekstin si në vijim:

11. Përrjashtimisht nga paragrafët 1 deri në 10, DSHAM nxjerr vendim për largim vullnetar në raste si në vijim;

12. Refuzimi i kërkesës për leje qëndrim;

13. Revokimi i leje së qëndrimit.

Neni 32

Pas nenit 94, të ligjit bazik, shtohet neni 94/A, me tekstin si në vijim:

Neni 94/A

Kthimi i asistuar vullnetar

1. Kthimi i asistuar vullnetar është largimi i të huajit në shtetin e origjinës në bazë të vendimit për kthim. Me qëllim të nxitjes së kthimit të asistuar vullnetar, policia mund të shfuqizojë vendimin për largim ose të shfuqizojë ndalesën e hyrjes dhe qëndrimit.

2. Me qëllim të nxitjes së kthimit të asistuar vullnetar, Ministria mund të lidhë marrëveshje apo të bashkëpunojë me organet kompetente të shteteve të tjera, organizatat ndërkombëtare dhe me organizatat e shoqërisë civile.

3. Me qëllim të nxitjes së kthimit të asistuar vullnetar, DSHAM mund të sigurojë dokumentet e udhëtimit dhe biletat e udhëtimit, si dhe të kryejë pagesat financiare.

Neni 33

Neni 95, i Ligjit bazik, riformulohet si në vijim:

I huaji ka të drejtë ankese kundër vendimit për largim vullnetar brenda tetë (8) ditëve nga dita e pranimi të vendimit të largimit vullnetar në Komisionin e Ankesave.

Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të ankesës. Ankesa kundër vendimit për largim vullnetar e pezullon ekzekutimin e vendimit për largim vullnetar. Kundër vendimit të Komisionit të Ankesave, i huaji mund të hapë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e vendimit. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit të largimit vullnetar.

Neni 34

Neni 97, pas paragrafit 1.5 të Ligjit bazik, shtohet paragrafi i ri 1.6 me tekstin si në vijim:

1.6. paraqet rrezik për rendin publik, sigurinë shtetërore apo shëndetin publik.

Neni 35

Pas nenit 97, të ligjit bazik, shtohet neni 97/A, me tekstin si në vijim:

Neni 97/A

Kategoria e të huajve që nuk iu lëshohet Vendim largimi

1. I huaji nuk dëbohet nëse e plotëson njëri nga kushtet e mëposhtme:

1.1. Është i pajisur me lejeqëndrim të përhershëm;

1.2. Ka lindur në Republikën e Kosovës;

1.3. Ka hyrë në Republikën e Kosovës si fëmijë i pashoqëruar dhe është pajisur me lejeqëndrim të përhershëm;

1.4. Është i pajisur me leje të përkohshme qëndrimi dhe është martuar me një të huaj, i cili ka leje të përhershme qëndrimi ose me një shtetas të Kosovës;

1.5. Ekziston dyshimi i bazuar se i huaji, në vendin e origjinës apo në një vend tjetër, do të dënohet me vdekje, do t'i nënshtrohet torturës, trajtimit çnjerëzor e degradues apo dënimeve për shkaqe diskriminuese;

1.6. Fëmija i pashoqëruar, nëse nga vendi i origjinës, një vend tjetër ose nga institucione të tjera nuk garantohet ribashkimi familjar ose kujdesi i duhur shëndetësor;

1.7. Është anëtar i familjes së të huajit, të cilit i njihet statusi i refugjatit në Republikën e Kosovës;

1.8. Personi i cili ka parashtruar kërkesë apo personit të cilit i është njohur statusi i personit pa shtetësi, si dhe pasardhësit të drejtpërdrejtë të personit që i është njohur statusi i pa shtetësisë.

2. Përrjashtimisht, i huaji mund të dëbohet edhe pse përmbushen kushtet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, në qoftë se qëndrimi i tij rrezikon rendin dhe sigurinë

publike si dhe përbën kërcënim për sigurinë shtetërore.

Neni 36

Neni 98, i Ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

I huaji ka të drejtë ankese brenda tetë (8) ditëve, pas pranimit të vendimit të largimit me forcë të Komisioni i Ankesave. Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit të ankesës. Ankesa kundër vendimit lidhur me vendimin e largimit me forcë, e pezullon ekzekutimin e vendimit të largimit me forcë, përjashtimisht rasteve që paraqesin rrezik për rendin publik, sigurinë shtetërore apo shëndetin publik. Kundër vendimit të Komisionit të Ankesave, i huaji mund të hapë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore brenda tridhjetë (30) ditëve pas pranimit të vendimit. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit të largimit me forcë.

Neni 37

Neni 99, 100 dhe 101 i Ligjit bazik” fshihen.

Neni 38

1. Titulli i nenit 107, i Ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

“Qendra për Mbajtjen e të Huajve”

2. Neni 107, paragrafi 1 dhe 4, i Ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Qendra për Mbajtjen e të Huajve duhet të ketë nivel të caktuar të sigurisë dhe kufizim të lirisë në të cilin mund të mbahen vetëm të huajt të cilët janë subjekt i largimit me forcë nga territori i Republikës së Kosovës.

4. Qendra për Mbajtjen e të Huajve është pjesë e strukturës organizative të DSHAM-së.

Neni 39

Pas paragrafit 4 të nenit 108 të Ligjit bazik shtohen dy paragrafe të reja 5 dhe 6, me tekstin si në vijim:

5. Përjashtimisht nenit 107 dhe 108 të ligjit bazik, të huajve, të cilëve u është dhënë vendim largimi me forcë dhe janë ndaluar në Qendrën për Mbajtjen e të Huajve, në rast se i plotësojnë kushtet, të huajt për kthim vullnetar i revokohet vendim largimi me forcë dhe i jepet vendim largimi vullnetar.

6. DSHAM, mund ta ndalojë aplikuesin në Qendrën e Mbajtjes në rastet kur konsideron të nevojshme dhe në bazë të një vlerësimi individual të secilit rast, dhe në qoftë se me masa të tjera alternative më pak shtrënguese alternative nuk mund të arrihet qëllimi i kufizimit të lirisë së lëvizjes, sipas Ligjit për Azil.

Neni 40

Neni 109, i ligjit bazik, riformulohet si në vijim:

1. I huaji ka të drejtë të parashtrojë padi kundër vendimit për ndalim në Gjykatën Themelore brenda afatit prej tridhjetëditëve (30) ditëve pas pranimit të vendimit për ndalim ose zgjatjen e ndalimit. Padia nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit.
2. Pala e pakënaqur me vendimin e Gjykatës mund të parashtrojë ankesë në Gjykatën e Apelit. Ankesa kundër vendimit të Gjykatës Themelore nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit.

Neni 41

Neni 115, paragrafi 5, i ligjit bazik riformulohet si në vijim:

5. Sekuestrimi i mjeteve financiare sipas këtij neni bëhet nga DSHAM me qëllim të mbulimit të shpenzimeve.

Neni 42

Pas nenit 119, të Ligjit bazik, shtohet nen i ri 119 A, me tekstin si në vijim:

Neni 119 A**Caktimi i Personelit për Migrim në Misionet Jashtë Vendi**

1. Ministria e Punëve të Brendshme me pëlqimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme mund të caktoj personel për Migrim në misionet jashtë vendi.
2. Detyrat dhe përgjegjësit financiare për personelin për migrim të caktuar në misionet jashtë vendit përcaktohen me Marrëveshje të Shkallës së Shërbimit të lidhur ndërmjet të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

Neni 43

Neni 128, paragrafi 2 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

2. Nga Inspektorati i Punës me gjobë në shumë prej njëmijë (1.000) deri dymijë (2.000) euro dënohet punëdhënësi si person fizik, me gjobë në shumën prej pesëmijë (5.000) deri shtatëmijë (7.000) euro do të dënohet punëdhënësi si person juridik, ndërsa personi përgjegjës i personit juridik dënohet me gjobë në shumën prej njëmijë (1.000) deri në dymijë (2.000) euro, i cili:

Neni 44

Neni 129, paragrafi 1, i Ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

1.Me gjobë prej njëqind (100) deri pesëqind (500) euro do të dënohet nga policia një i huaj i cili:

Neni 45

Neni 130, paragrafi 1, i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

1.Nga Inspektorati i Punës me gjobë në shumë prej njëmijë (1.000) deri dymijë (2.000) euro do të shqiptohet nëse i huaji:

Neni 46

Neni 131, paragrafët 1, 2, 3 dhe 4, të Ligjit bazik, riformulohen me tekstin si në vijim:

1. Me gjobë në shumë prej njëmijë (1.000) deri dymijë (2.000) euro për çdo të huaj të transportuar, do të dënohet nga policia transportuesi i të huajit të cilët nuk kanë pasaportë të vlefshme ose dokument tjetër që përdoret për kalimin e kufirit, vizë të vlefshme ose leje qëndrimi (neni 35 paragrafi 2. i këtij ligji).

2. Me gjobë në shumë prej njëmijë (1.000) deri dymijë (2.000) euro për çdo të huaj të transportuar, do të dënohet nga policia transportuesi si person fizik i cili me shpenzimet e veta nuk e ka dërguar (larguar) të huajin deri të vendkalimi i kufirit ose nga Republika e Kosovës ose nuk i ka marrë përsipër shpenzimet për kthimin e të huajit (neni 35, paragrafi 3., 4. dhe 5. i këtij ligji).

3. Me gjobë në shumën e njëmijë (1.000) deri dymijë (2.000) euro për çdo të huaji të asistuar, do të dënohet nga policia personi fizik i cili ndihmon një të huaj në mënyrë të paligjshme të kalojë kufirin, transit dhe qëndrimin të paligjshëm në Republikën e Kosovës (neni 36 i këtij ligji).

4. Me gjobë në shumën prej pesëmijë (5.000) euro do të dënohet nga Policia një person juridik në rastin e paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni, me gjobë në shumën prej dymijë (2.000) euro personi përgjegjës në personin juridik, për çdo të huaj të transportuar, apo të ndihmuar.

Neni 47

Neni 132, paragrafët 1, 2, 3, 4, dhe 6 të Ligjit bazik, riformulohen me tekstin si në vijim:

1. Nga Inspektorati i Punës me gjobë në shumë prej tremijë (3.000) deri pesëmijë (5.000) euro për çdo të huaji do të dënohet punëdhënësi - një person fizik i cili e ka punësuar një të huaj ose e përdor punën e tij, dhe me gjobë në shumën prej dhjetëmijë (10.000) deri në njëzetëmijë (20.000) euro për çdo të huaj do të dënohet punëdhënësi - një person juridik i cili ka punësuar një të huaj ose e përdor punën e tij.

2. Nga Inspektorati i Punës me gjobë në shumë prej tremijë (3.000) deri pesëmijë (5.000) euro për çdo të huaji do të dënohet punëdhënësi - personi fizik që punëson ose përdor punën e të huajve që banojnë ilegalisht në Republikën e Kosovës, dhe me gjobë në shumën prej dhjetëmijë (10.000) deri njëzetëmijë (20.000) euro për çdo të huaj do të dënohet punëdhënësi - një person juridik që punëson ose përdor punën e të huajve që

banojnë ilegalisht në Republikën e Kosovës (neni 67, paragrafi 7. i këtij ligji).

3. Për shkeljet e referuara në paragrafin 1. të këtij neni, do të dënohet nga Inspektorati i Punës me një gjobë prej një mijë (1.000) deri dymijë (2.000) euro personi përgjegjës i personit juridik.

4. Për shkeljet e referuara në paragrafin 2 të këtij neni me gjobë në shumën prej një mijë (1.000) deri dymijë (2.000) euro, do të dënohet nga Inspektorati i Punës personi përgjegjës në personin juridik.

6. Nga Inspektorati i Punës me gjobë prej tremijë (3.000) deri në pesëmijë (5.000) euro do të dënohet punëdhënësi-personi fizik, me një gjobë prej dhjetëmijë (10.000) deri në njëzetmijë (20.000) euro do të dënohet punëdhënësi- personi juridik i cili nuk ofron të dhëna apo pengon qasjen në hapësira të mbyllura apo të rrethuara të pronës komerciale.

Neni 48

Neni 133, paragrafët 3 dhe 4, të Ligjit bazik, riformulohen me tekstin si në vijim:

3. Inspektorati i Punës me gjobë prej një mijë (1.000) deri dymijë (2.000) euro do ta dënoj çdo të huaji si marrës i shërbimit, nëse ai e di ose ka arsye për të ditur se për punë e përdorë një punëtor të sistemuar i cili nuk është i punësuar ligjërisht nga një punëdhënësi i huaj (neni 77 i këtij ligji);

4. Inspektorati i Punës me gjobë prej një mijë (1.000) deri dymijë (2.000) euro për çdo të huaji për shkeljet e referuara në paragrafin 3. të këtij neni, do të dënohet përfituesi, personi fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik.

Neni 49

Neni 137 i ligjit bazik, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2, bartet si paragraf i veçantë pas paragrafit 5, si dhe riformulohet me tekstin si në vijim:

6. Përbërja, detyrat, përgjegjësitë dhe procedurat e vendimmarrjes së Komisionit të Ankesave do të rregullohen me akt nënligjor, i cili miratohet në Qeveri, sipas paragrafit 4 të nenit 9 të këtij ligji.

Neni 50

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 06/L -036

30 mars 2018

Shpallur me dekretin Nr. DL-019-2018, datë 20.04.2018 nga Presidenti i Republikës së Kosovës Hashim Thaçi